**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit**
**Kuvendi i Komunës**

02-**Nr.**060/03-13506 **dt.**17/03/**2023**

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **24.03.2023**, (E Premte) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i KK i mbajtur me dt. 23.02.2023.
2. Propozim vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit.
3. Propozim vendim për caktimin e anëtareve të komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendësdrejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit.
4. Propozim vendim për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale në zonën kadastrale në Çikëtove të Vjetër dhe Gllogoc, për projektin e rregullimit të ngrohtores së qytetit të Drenasit.
5. Propozim vendim për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Gllogoc, i plotësuar.
6. Propozim vendim për vënien në diskutim publik e rregullores për Bonuset e Zonimit, i plotësuar.
7. Propozim vendim për miratimin e Raportit përfundimtar të Komisionit Komunal për vlerësimin e Dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera.
8. Të ndryshme.

Drenas, 17.03.2023

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit**
**Zyra e Kuvendit**

**Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 17. 03.2023, si vijon:**

Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K. P. F-ca, për rendin e ditës, ku i njoftoi se kemi edhe tri pika shtesë shtesë, dy janë në rishqyrtim :1. Propozim vendim për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Gllogoc, i plotësuar.

1. Propozim vendim për vënien në diskutim publik e rregullores për Bonuset e Zonimit, i plotësuar.
2. Propozim vendim për miratimin e Raportit përfundimtar të Komisionit Komunal për vlerësimin e Dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera.

Sa për sqarim ja dha fjalën kryetarit Ramiz Lladrovci,pastaj i pyeti të pranishmit nëse ka dikush debat rreth pikav të rendit të ditës mundet me marr fjalën, diskutime nuk pati hedhi në votim rendin e ditës.

- **Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 16.02.2023.
   - **Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

2. Propozim vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit.
   - **Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

3. Propozim vendim për caktimin e anëtareve të komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendësdrejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit.
   - **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
4. Propozim vendim për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale në zonën kadastrale në Çikatovë të Vjetër dhe Gllogoc, për projektin e rregullimit të ngrohtores së qytetit të Drenasit.
   - **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
5. Propozim vendim për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Gllogoc, i plotësuar.
   - **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
6. Propozim vendim për vënien në diskutim publik e rregullores për Bonuset e Zonimit, i plotësuar.
   - **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

7. Propozim vendim për miratimin e Raportit përfundimtar të Komisionit Komunal për vlerësimin e Dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera.
   - **Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

8. Të ndryshme.

-Pati një kërkesë nga Hamit Hagjiu ,propozoi që në Kuvend të vijë si pikë shtesë që anëtarët e Bordit të Kompanisë së Pastrimit të bëhen me pagesë ,ose për përcaktimin e Kompensimit të anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në ndërmarrjen Publike Lokale Pastrimi.

**Pasi përfunduan diskutimet mbledhja përfundoi në ora 11: 00.**

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Milaim Hajdari**

Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

02 Nr.-063/04-12753 dt. 13/03/2023

# PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **23.02.2023**

**Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari**

**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 31 anëtarë:** Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Agnesë Kastrati (PDK), Albulena Saliuku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK), Valentina Leku (PDK), Sali Dvorani (DD) Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK).
Mungoj Muhamet Kurtaj.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Znj Manushaqe Mulaku, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal Drenas, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës" duke zëvendësuar znj. Agnesë Kastrati-Bucolli e cila lirohet prej detyrës të anëtares së Kuvendit Komunal.
2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 25.01.2023.
3. Propozim vendim për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027.
4. Propozim vendim për miratimin e Projekt Rregullores nr.01/2023 për Menaxhimin e mbeturinave për Komunën e Gllogocit.
5. Raporti i Punës Janar-Dhjetor 2022 i Kryetarit të Komunës.
6. Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027.
7. Propozim vendim për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Gllogoc.
8. Propozim vendim për vënien në diskutim publik e rregullores për Bonuset e Zonimit.
9. Plani i punës për vitin 2023,i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)
10. Të ndryshme.

Të mekurën me dt. 23.02.2023 është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit, ku për diskutim ishin 10 pika për rend dite.
Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, ndërsa merrnin pjesë, kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale, anëtarët e Kuvendit, zyra e informimit.

Më poshtë ju elaborojmë pikat që janë diskutuar e miratuar me shumicë votash në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtaret e Kuvendit Komunal.

**Beqir Kiqina,** kërkoj që në procesverbal tek pika e parë e rendit të ditës znj. Manushaqe Mulaku emërohet anëtare, jo emërohet anëtare por betohet.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 25 anëtar, **(Për)** votuan 25 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua rendi i ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës Znj Manushaqe Mulaku, betohet si anëtare e Kuvendit Komunal Drenas, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës" duke zëvendësuar znj. Agnesë Kastrati-Bucolli e cila lirohet prej detyrës të anëtares së Kuvendit Komunal.

Znj Manushaqe Mulaku, betohet si anëtare e Kuvendit Komunal Drenas, më datë: **23.02.2023.**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 25.01.2023.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar, **(Për)** votuan 27 anëtar, kundër nuk pati, 1 abstenim, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027.**

**Arbër Halilaj,** Jam i lumtur që sot para vetes kemi Planin Komunal për MM, meqë i njëjti direkt ndikon në ruajtjen e mjedisit jetësor, zhvillimin më të madh ekonomik e bujqësor të komunës, vetëdijesimin e popullatës dhe rrjedhimisht përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve tanë, si synim parësor. Në Plan janë inkorporuar edhe objektivat strategjike të PZHK 2020-2028 si dhe Planit Lokal të Veprimit në mjedis 2020-2025.
Po ashtu, qëllimet e Planit për menaxhimin e mbeturinave për periudhën planifikuese 2023-2027 janë të harmonizuara me qëllimet strategjike nga PZHK dhe Plani i Menaxhimit të Mbeturinave të Republikës së Kosovës, ndërsa duhet siguruar mjete nga buxheti komunal, si dhe kërkimin e mundësive për financim nga niveli qendror dhe burime të tjera, meqë veprimet e parapara në Plan kanë kosto financiare.

Një qëllim strategjik i Planit duhet të jetë edhe **zvogëlimi i ndotjes së ambientit jetësor dhe rrezikut nga katastrofat natyrore**, që janë ngushtë të ndërlidhura edhe me mënyrën e menaxhimit të mbeturinave në nivelin lokal, gjë që u pa sidomos në përmbytjet e fundit në Skënderaj dhe disa komuna tjera.

Pra, ne mund të konstatojmë se jemi të kompletuar sa i përket rregullativës ligjore lokale dhe nacionale, strategjisë dhe planeve, ndërsa periudha e deritashme e ka dëshmuar se operatori i licensuar për M.M. ka dështuar në aspektin operativ dhe logjistik të menaxhimit të mbeturinave në territorin e Komunës së Drenasit. Kjo duhet të kihet parasysh në Plan, duke synuar përshpejtimin e procesit të kalimit në një model tjetër të MM, përmes funksionalizimit të NPL për këtë qëllim, por të cilës do të mund t'ia zgjeronim fushëveprimin edhe me disa aktivitete tjera në shërbim të qytetarëve.
Kur kemi parasysh faktin e operimit afër qendrës së Drenasit të industrisë së Ferronikelit, që ndotë ajrin, ujin dhe tokën e komunës sonë, duke shkaktuar dëme të pakthyeshme, atëherë del se gjendja me MM dhe në përgjithësi me mjedisin jetësor në Drenas, është jo vetëm në nivel të pakënaqshëm siç ceket shkarazi në Plan tek pjesa e gjendjes ekzistuese, por është në nivel të degradimit të pakthyeshëm mjedisor. Tek gjendja aktuale e mjedisit, askund nuk përmendet obligimi i parealizuar i revitalizimit të resurseve natyrore të degraduara dhe hapësirave dhjetëra hektarëshe të mbuluara me skorie e materie tjera të rrezikshme, siç bëhet në botën e zhvilluar. Në Plan vetëm konstatohet shfrytëzimi i egër i resurseve ujore, dëmtimi i shtretërve të lumenjve, resurseve pyjore si dhe derdhja e pakontrolluar dhe e pamonitoruar e ujit industrial në lumin Drenica, ku pothuajse është shkatërruar biodiversiteti ujor, që e dëshmon se çfarë uji derdhet aty. Kur kësaj i shtohet fakti i cekur në Plan se bashkë me ujin nga procesi industrial në Ferronikel, në lumin Drenica derdhen ujërat e kanalizimeve të qytetit dhe fshatrave të patrajtuara në impiante, këtu çdo koment është i tepërt. Menaxhimi jo i mirë i mbeturinave komunale vetëm sa e rëndon këtë gjendje, prandaj në Plan duhet të kishte më shumë veprime e planifikime për ndryshim të kësaj gjendjeje të lartcekur, për aq sa mund të ndryshohet.
E përkrah kalimin në faturim vëllimor, që do të dekurajonte krijimin e sasisë së madhe të mbeturinave, si dhe zbatimin e parimit "ndotësi paguan" e aq më tepër implementimin e shtyllës së programit të Iniciativës sonë, që është ekonomia qarkore, e cila tek mbeturinat aplikon parimin konsumo-reciklo-ripërdor. Kjo do t'i kthente një pjesë të madhe të mbeturinave në lëndë të parë, dhe rrjedhimisht do të reduktohej sasia që hudhet.
Në Plan shihet se jemi në fillimet e klasifikimit të mbeturinave në bazë për reciklim, gjë që duhet të jetë fokusi i Planit për periudhën vijuese. Bashkëpunimi me operatorët ekonomik privat dhe investitorë të jashtëm është krucial tek kjo fazë. Informimi dhe vetëdijësimi i qytetarëve përmes broshurave, mediave dhe formave tjera të informimit, duket si element më lehtë i realizueshëm, por që duhet ta ketë rëndësinë dhe prioritetin e vet në Plan.
Nuk pashë në Plan ndonjë analizë të llojeve të mbeturinave që krijojnë industria dhe bizneset apo operatorët ekonomik të Komunës sonë, varësisht nga Fushë veprimtaria e tyre. Këto biznese duhet të mendojnë edhe për zgjidhje vetanake sa i përket mbetjeve industriale nga puna e tyre, e jo të lejohen të deponojnë mbeturina në kontejnerët e ekonomive familjare. Ekonomitë familjare në anën tjetër janë paguesit më të rregullt të faturave nga të gjithë prodhuesit e mbeturinave, siç shihej në të dhënat statistikore të planit.
Gastronomia ka mundësi që vajrat e mbetura, që janë ndotës i madh, bashkë me vajrat tjera motorike dhe industriale, t'i eliminojnë duke bashkëpunuar me operator që po merren me grumbullimin e këtyre mbetjeve, në mënyrë që ato të mos hedhen vend e pa vend.
Edhe mbeturinat e rrezikshme, siç janë komponentët elektronike, përmenden në Plan por me një konstatim se nuk është bërë zgjidhje për to dhe do të punohet në të ardhmën.
Të gjitha këto çështje të pazgjidhura, e imponojnë që objektivi i parë i planit sipas mendimit tim të jetë:

1. Reduktimi i rreziqeve për mjedisin dhe shëndetin e njeriut për shkak të mostrajtimit të duhur të mbeturinave.

sepse qëllimi primar i Strategjisë nacionale, Planit dhe Rregullores komunale për MM, si dhe obligimi ligjor i Komunës është mbrojtja e shëndetit dhe jetës së qytetarëve.
Plani në përgjithësi parasheh objektiva dhe veprime operacionale për të ardhmen e afërt, por nuk e ka të përcaktuar koston financiare të këtyre veprimeve, synimeve dhe aktiviteteve, që do ta bënte më të kompletuar si Plan. Por, pavarësisht këtyre theksimeve të mia, Plani si përmbajtje është korrekt dhe i konstaton problemet kryesore sa i përket gjendjes ekzistuese dhe synimet ku synohet të arrihet brenda periudhës që mbulon ky Plan, prandaj fuqimisht e përkrah si një dokument tepër të rëndësishëm për zhvillimin e komunës sonë, në implementimin e të cilit secili duhet të japim kontributin tonë.

**Egzona Tërdevci,** dua të ndalem të dy kompetentet e planit, tek mbështetja e kompanisë pastrimi me pajisje dhe forma të tjera mbështetëse sipas marrëveshjes së komunës dhe kompanisë dhe denctrenalzimit KRM pastrimi në aspektin financiar, vazhdimisht në ketë kuvend e kemi diskutuar pa përgjegjshmërinë e kompanisë pastrimi në raport me shërbimet që ia ka ofruar qytetareve, nuk po kuptoj pse me vazhdu me i dhënë mbështetje kur nuk i përmirësojnë shërbimet, kërkoj sqarim për ketë pjesë.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** sa i përket fjalimit të Egzones, në rast se ne e shkëputim kontratën me kompaninë KRM pastrimi çka me vepru pastaj duhet me pas një zgjidhje, ne jemi duke e bërë kompani komunale dhe i marrim përgjegjësit pastaj ne si komunë.

**Egzona Tërdevci,** ne nuk jemi kundër me i mbështet qoftë me pajisje qoftë me mjete financiare, ideja është që mbështetja që ne ia ofrojmë ne si komonë lë të kthehet në shërbime me të mira për qytetaret.

**Hamit Haxhiu-** pyeti për planin komunal për menaxhimin e mbeturinave, këtu në përmbajtje hyn edhe arsimi, shëndetësia bujqësia etj a kanë ndonjë korrelacioni këto apo është vetëm si material shtesë për ketë pikë?

**Lumnije Krapi- Drejtoreshë për Shërbime Publike dhe Emergjencë-** Fillimisht ky draft dokumente është punuar prej grupit punues në grupin punues janë involvuar të gjithë zrtarët që kan punuar në fushat të caktuara domethënë janë të involvuar drejtoria e arsimit, shëndetsisë, bujqësis domethan në të gjitha ato të dhëna që është dashur të inkorpurohen në planin e menagjimit të mbeturinave, gjithashtu ky draft dokument është hartuar në kordinim dhe bashkpunim të plot me Ministrin e Mjedisit dhe me Gizin Gjerman, gjithashtu përpara se me ardh për miratim I ka kaluar të gjitha procedurat ligjore sipas legjislacionit në fuqi, me kët draft dokument synojm te avancohet procesi I sistemit të menagjimit të mbeturinave që është një ndër kopetencat e Komunës të përcaktuar me nenin 17 të të ligjit për vetqeverisje locale, edhe një her po e potencoj po ndërlidhem edhe me Arbrin se në planin e menagjimit të mbeturinave 2015-2021 Komuna e Drenasit ka arritur të gjitha objektivat që kan qen të parapara në planin paraprak, kjo do të thotë se mbulushmërin e sherbimit të mbeturinave kemi 100% e gjithë territorit, inkasimin ose arktimin e kemi 87% dhe largimin e 117 deponive ilegale gjithashtu Brenda këti afati është fillu edhe me procesin e ndarjes I kemi procesin e ndarjes ne disa zona në qendrën e Drënasit e kemi nje pjesë të Komoranit, Çikatoves edhe Poklekut të ri poashtu kemi fillu edhe procesin e kompostimit shtëpiak. Marre parasysh rezultate te pritshme te objektivave te Planit Komunal të Menaxhimi te

mbeturinave 2015 -2021, Komuna e Drenasit ka arritur realizimin e gjitha objektivave qe kanë qene te planifikuar për mandat pesëvjeçar te planit KMM 2015 -2021 ; si mbulushëria e shërbimit ne gjithë territorin, shkalla e inkasimit mbi 87%, largimin e 137 deponive. Eshte filluar me procesin e ndarjes se mbeturinave ne burim si dhe procesin e kompostimit shtëpiak.

Draft dokumenti i Planit komunal i menaxhimit te mbeturinave për vitin 2023- 2027, është fokusuar në 5 objektiva kryesore te cilat brenda afatit 5 vjeçar pritet implementimi i dhe avancimi i tyre.
**Objektivi kryesor** është fokusuar Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave

**Objektivi 2:** Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave
Fokusi primar i këtij objektivi ka të bëjë me ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale te gjitha kategorive qe jane kompetenc komunale.

**3: Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qendrueshme të MM,**
Ky objektiv synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve me theks të aspekteve të qendrueshmërisë financiare dhe të kostos.

**Objektivi nr. 4:** Eliminimi i deponive ilegale.
Ky objektiv i referohet gjendjes aktuale në teren, ku për çdo vit evidentohet një numër i caktuar i vend hedhjeve ilegale të mbeturinave

**Objektivi 5:** Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave
Ku perfshihen, Planet , Rregullore

Tashmë draft dokuminti eshte konsultim publik dhe pas miratimit ne kuvend brenda afatit 5 vjeqar 2023-2027 mund te behet plotesim, ndryshim sipas ligjislacioneve ne fuqi.
Marr parasysh situatat e krijuar vitet e fundit si pandemia, inflacioni ekonomik, fatkeqesite natyrore, ne planifikim te hartimit te planit te menaxhimit te mbeturinave eshte parapare edhe Plani i MM në kushte emergjente.

Ligjit nr. 04/l-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Planit kombëtar të reagimit emergjent
Gjendja ekzistuese e menaxhimit të mbeturinave
Të dhënat për mbeturina në komunë

**Hamit Haxhiu,** këtu në plan e kam lexuar disa prej pikave duke marrë arsimin, turizmin, etj, nuk po shoh që ka ndonjë lidhshmëri kjo pikë me arsimin, tjetra qerdhet tri janë, 1 private dhe 2 publike kjo shifër sikur me qene viteve me herët sepse çerdhe private ka me shumë, por sikur këto të dhëna janë marrë prej vitit 2017.

**Lumnije Krapi- Drejtoreshë për Shërbime Publike dhe Emergjencë,** e ceka edhe me herët ne grupin punues janë ne involvuar gjithë zyrtaret e drejtorive që na duhen informata ose të dhënat me i involvu, në drejtorinë e arsimit na duhen informatat e shkollave, sa mbeturina gjenerojnë që kanë të bëjnë me këtë pikë, të dhënat i kemi të vitit 2021, gjitha këto te dhëna janë të sakta të cilat verifikohen nga Ministria e Planifikimit.

**Hamit Haxhiu,** po ndalem edhe tek bujqësia ku thotë vlerësimi i tokës bujqësore këto shënime të cilat janë referohen duke u bazuar ne vitin në vitin 2017 qfar raporti keni ju për

vitin 2022, pemëtaria krahasimet e mbjella për këtë vit është është fjala për vitin 2014-2018 çfarë raporti kemi për vitin 2018-2022, për pas përmendet edhe turizmi lokal nder ta përmendet edhe liqeni i Vasileves, nuk e di çka e keni përmend liqenin e Vasileves kur nuk ka kurrfarë infrastrukture.

**Lumnije Krapi- Drejtoreshë për Shërbime Publike dhe Emergjencë,** të dhënat demografike që janë te vendosura në çdo plan pa marrë parasysh a është plani i menaxhimit të mbeturinave a plani i mjedisit ne veprim, mirëpo ne çoftë se secila drejtori nuk i ka të dhënat e e tanishme atëherë ne i marrim edhe i involvojme te dhënat sepse e ka afatin e caktuar, edhe ato janë te dhëna valide.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për miratimin e Projekt Rregullores nr.01/2023 për Menaxhimin e mbeturinave për Komunën e Gllogocit.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar, **(Për)** votuan 28 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Raporti i Punës Janar-Dhjetor 2022 i Kryetarit të Komunës.**

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** para jush e keni raportin janar-dhjetor e Punës Janar-Dhjetor 2022 te kryetarit dhe qeverisjes lokale, zyra e kryetarit ka organizuar dy takime me publikun sipas ligjit për vetëqeverisje lokale, për të diskutuar aktivitete e gjashtë mujorit të parë dhe gjashtë mujorit të dytë, po ashtu janë mbajtur pesëmbëdhjetë dëgjime buxhetore, tetë për kornizën afatmesme buxhetore 2022-2024 dhe kërkesat fillestare me qytetaret e Komunë së Drenasit dhe shtatë të tjera për investime kapitale, janë mbajtur edhe gjashtë mbledhje me KKSB-në, 54 mbledhje te bordit, janë nxjerrë 349 vendime.

**Egzona Tërdevci,** në kohën kur është prezantuar plani i punës në janar të vitit të kaluar kane qenë dy zotime publike të kryetarit të komunës se gjatë vitit 2022 do të përfundoj komplet ndriçimi publik në komunë neper vende ku ka shtylla të betonit si dhe furnizimi me ujë të pijes, një vit mbrapa ku jemi me këto objektiva, pyeti për drejtorinë e Arsimit plani i punës që na është prezantuar ne fillim të vitit të kaluar vërejmë që nuk janë realizuar dy projekte kapitale, behet fjalë për digjitalizimin e shkollave projekt ne vlere 80 mijë euro, dhe për ndërtimin e depove për lëndë djegëse, cilat janë arsyet apo pengesat që i keni pas për mos realizim të këtyre projekteve për infrastrukturën publike, kur na kanë dergu planin na kanë dërguar edhe projketet në detaje cilat kanë me u realizu, por tani që e kemi marrë raportin e punës janë vetëm asfalti, kanalizimet e paraqitura ne metra por jo edhe vendet ku janë realizuar, a mundem me ditë nëse janë realizuar gjitha projektet që janë planifikuar për vitin 2022, tek shëndetësia dy AMF, në Vasileve, Poklek dhe në Abri të Eperme vazhdojnë të mbesin jo funksionale nëse mundemi me i ditë arsyet pse nuk po funksionojnë këto dy AMF, po ashtu është bërë më shumë se një muaj që drejtoria për kadastër funksionon pa drejtor, kur e keni ndërmend me emërua drejtorin për ketë dikaster. Edhe për Drejtorinë e shëndetësisë a ka Drejtoria e shëndetësisë drejtor?

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** këto pyetje nuk janë për këtë pike të rendit të ditës, mundeni tek pika tek të ndryshmet me i parashtru dhe mund të përgjigjemi, ndërsa sa i përket. Është e vërtetë që kemi pas zotim të për ndriqim të gjitha lokaliteteve të komunës tonë me drita, kërkesën degoja në nivelin qendror pse nuk është realizuar ky projket akoma në Komunën e Drenasit sepse për dy vjet rresht nuk e ka funksionalizuar ASHP-në, lënda e cila ka qenë në ASHP është akoma në ASHP, sa i përket ujit jemi duke bërë maximumin për të pas ujë çdo njeri, është për këtë bëjeni pyetjen tek niveli qendror pse na i kanë hek mjetet e ndara për ujëgrumbulluesin e Verbocit apo për liqenin e Verbocit ku do t'i furnizonte 40 mijë banor më ujë të pijes, pra ky kuvend e ka shpall interes të përgjithshëm atë zonë, i ka siguruar mjetet dhe kodin buxhetor, me ardhjen e Qeverisësë Kurti Komuna e Drenasit është penalizuar, dhe nuk i ka as në kod këto projekte i kanë heq krejt.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hapi diskutimin për piken tjetër

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027.**

**Arben Shala-Nënkryetari i Komunës se Drenasit,** tashme dihet dhe është dëshmuar që Komuna e Drenasit ka përkrahur dhe vazhdon të përkrah një qeverisje të hapur dhe demokratike, transparente, efektive dhe efikase. Plani i veprimit për transparence 2023-2027 mundëson hapjen e komunës për qytetaret pjesëmarrjen e tyre në procesin e vendimmarrjes dhe paraqet një përpjekje për të rritur edhe me tej efikasitetin, trajtimin dhe cilësinë e shërbimeve publike. Komuna jonë ashtu siç ka qenë deri me tani transparente do të vazhdoj të jetë e tillë me synime të qarta të përmirësimit e rritjes se transparencës. Ne jemi vlerësuar nder më transparentete edhe sa i përket qasjes ne dokumente zyrtare për të gjithë pa marrë parasysh a janë asamblistë, OJQ, apo qytetar individual, me dokumente të prokurimit të publikuara në ueb-faqe dhe duke ftuar qytetaret në takime e konsultime publike.
Sigurisht krejt kjo që u tha më lartë nuk na lejon të vet kënaqemi dhe qeveria Lladrovci synon rritje dhe përmirësimin e vazhdueshëm të transparencës dhe llogaridhënies duke ndjekur praktikat demokratike e të dëshmuara nderkombetarisht, dhe ky plan është në funksion të këtij qëllimi dhe ju ftoj ta votoni atë.

**Egzona Tërdevci,** patëm kërkuar që edhe mbledhjet e komiteteve të përhershme me qenë online për shkak të transparencës.

**Hamit Haxhiu,** kërkoj që votimi të bëhet në mënyrë digjitale.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, **(Për)** votuan 22 anëtar, kundër nuk pati, 4 abstenim, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: 7. **Propozim vendim për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Gllogoc.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar, **(Për)** votuan 27 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Propozim vendim për vënien në diskutim publik e rregullores për Bonuset e Zonimit.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 25 anëtar, **(Për)** votuan 25 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Plani i punës për vitin 2023, i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 25 anëtar, **(Për)** votuan 25 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Të ndryshme.**

**Egzona Tërdevci,** pyeti për drejtorinë e Arsimit plani i punës që na është prezantuar në fillim të vitit të kaluar vërejmë që nuk janë realizuar dy projekte kapitale, behet fjalë për digjitalizimin e shkollave projekt ne vlere 80 mijë euro, dhe për ndërtimin e depove për lëndë djegëse, cilat janë arsyet apo pengesat që i keni pas për mos realizim të këtyre projekteve për infrastrukturën publike, kur na kanë dërgu planin na kanë dërguar edhe projektet në detaje cilat kanë me u realizu

**Muhamet Gjoka- Drejtori i Arsimit,** mjetet e planifikuara për ketë projekt, janë shpenzuar për shfrytëzimin e kontratës kolektive.

**Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 12:00 min.**

*Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 23.02.2023 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Fecebook-ut dhe në kanalin YouTube.*

Procesmbajtëse:
Liridona Fejza-Ajazi

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Milaim Hajdari

**Republika e Kosovës**
**Komuna e Drenasit**
**Zyra e Kryetarit**

**01 Nr.** 020/04 - 12273 **dt.** 10.03. **2022**

Në bazë të nenit 11, 12 dhe 40 pika 40.2 shkronja e) dhe i) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më ______________________, miraton këtë:

# PROPOZIM VENDIM

**Për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit**

**Neni 1**

Me këtë vendim formohet komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Komunën e Drenasit në këtë përbërje:

1. ____________________
2. ____________________
3. ____________________
4. ____________________
5. ____________________

**Neni 2**

Me këtë vendim obligohet komisioni që të bëjë shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtimin e rrugëve dhe pas shqyrtimit të këtyre kërkesave dhe ankesave komisioni harton raportin dhe i propozon kuvendit listën për aprovim.

**Neni 3**

Me këtë vendim obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor që të bëjë regjistrimin për emërtim të rrugëve që merr vendim kuvendi për ndryshim apo emërtim të ndonjë rruge të re.

**Neni 4**

Mandati i komisionit përfundon me përfundimin e mandatit të asambleistit.

**Neni 5**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrim dhe vlerësim e ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në uebfaqen zyrtare e Komunës.

**Kryetari i Komunës**
**Ramiz Lladrovci**

______________________

# Arsyetim

Edhe pse komisioni paraprak ka bërë një punë të mrekullueshme dhe në mbledhjen e fundit të mandatit ka dorëzuar propozimet pas shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, kërkesave për riemërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit, puna nuk ka arritur të finalizohet për shkak të ligjshmërisë së vendimit të kuvendit për këtë çështje, përkatësisht propozimeve për emërtim dhe ri-emërtim të rrugëve.

I tërë emërtimi dhe riemërtimi të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike që ndryshe quhen "Zona për Qarkullimin Publik" duhet të bazohet në Ligjin Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave dhe në aktet nënligjore të këtij ligji në cilat parashihen edhe ndryshimet të cilat ndodhin në hapësire, zhvillimet e reja urbane, rrugët e reja, rastet kur rrugët duhet ose mund të ri-emërtohen etj.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe komuna ka pranuar një numër kërkesash për këtë qëllim.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Zyra e Kryetarit

**Nr** 01-020/04-12267 **dt.** 09.03. **2023**

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h)të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 6, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor, si dhe rekomandimit të DKA-së në Drenas, Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë______________2023, të aprovoi këtë:

# PROPOZIMVENDIM

**Për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zëvendësdrejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit**

**Neni 1**

Me këtë Propozim Vendim caktohen anëtaret e komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zëvendësdrejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit, si vijon:

1. Drilon Krasniqi – Fakulteti i Edukimit – Gjuhë Angleze ( 240 ECTS) + Fakulteti i Edukimit – Mësimdhënie dhe Korrikula (90 ECTS) dhe student i doktoratës për mësimdhënie në Slloveni.
2. Arben Haziri – Ma.sc. Gjuhë Shqipe ( Këshilli i Prindërve);
3. __________________- Anëtar nga MAShTI.

**Neni 2**

Ky komision ka për detyrë qe procedurat e përzgjedhjes së drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve t'i zhvilloj në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MASH) Nr.151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

**Neni 3**

Mandati i anëtareve të komisionit nga DKA për Drejtor dhe Zëvendësdrejtor në Institucione Arsimore është për 1 vit.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA GLLOGOC - OPSTINA GLLOGOC - GLLOGOC MUNICIPALITY

**Kryetari i Komunës**

______________

**Ramiz Lladrovci**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**KOMUNA E DRENASIT**
**Zyra e Kryetarit**
**Nr.01- 400/01-12498, dt. 10.03. 2023**

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72.2 paragrafi (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 29 Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin eProcedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 12 pargrafi 1 dhe paragrafi 2, nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 24 dhe nenit 25 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë__________2023 të miratoi këtë:

**PROPOZIM VENDIM**
**Për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale në zonën kadastrale në Çikatovë e Vjetër dhe Gllogoc, për projektin e rregullimit të ngrohtores së qytetit të Drenasit**

**I**

**TË MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e njësive kadastrale si në vijim:

Propozimi i parë i pronave komunale për këmbim:
- **P – 70315066-00829-1**, zona kadastrale Çikatovë e Vjetër,– pronë komunale, KK Gllogoc.
- **P – 70315066-00829-2**, zona kadastrale Çikatovë e Vjetër,– pronë komunale, KK Gllogoc.

Propozimi i dytë i pronave komunale për këmbim:
- **P – 70315066-00875-0**, zona kadastrale Çikatovë e Vjetër,– pronë komunale, KK Gllogoc.
- **P – 70315066-00876-0**, zona kadastrale Çikatovë e Vjetër,– pronë komunale, KK Gllogoc.

Propozimi i tretë i pronave komunale për këmbim:
- **P – 70315066-00881-0**, zona kadastrale Çikatovë e Vjetër,– pronë komunale, KK Gllogoc.

- Pronat e Newco Ferronikeli Complex L.L.C. për këmbim:
- **P –70315016-00269-2**, zona kadastrale Gllogoc, pronë private, pronar Newco Ferronikeli Complex L.L.C.
- **P –70315016-01013-0**, zona kadastrale Gllogoc, pronë private, pronar Newco Ferronikeli Complex L.L.C.

**II**

Qëllimi për këmbimin e këtyre pjesëve të njësive kadastrale, pronës private me pronën komunale të cekur në pikën **I** të këtij propozimi, është realizimi i projekti për ndërtimin e ngrohtores së qytetit të Drenasit.

**III**

Pronat e paluajtshme të cilat do të këmbehen kanë këto karakteristika:

Propozimi i parë i pronave komunale për këmbim:

- **P – 70315016-00829-1,** me sip.11745 $m^2$, me kultur kullosë e kl.4, zona kadastrale Çikatovë e Vjetër,– pronë komunale, KK Gllogoc.
- **P – 70315016-00829-2,** me sip.59428 $m^2$, me kultur kullosë e kl.4, zona kadastrale Çikatovë e Vjetër,– pronë komunale, KK Gllogoc. **Sipërfaqja për këmbim: 60000 $m^2$**

Propozimi i dytë i pronave komunale për këmbim:

- **P – 70315016-00875-0,** me sip.66130 $m^2$, me kultur kullosë e kl.3 , zona kadastrale Çikatovë e Vjetër,– pronë komunale, KK Gllogoc.
- **P – 70315016-00876-0,** me sip.29489 $m^2$, Tokë jo pjellore, zona kadastrale Çikatovë e Vjetër,– pronë komunale, KK Gllogoc. **Sipërfaqja për këmbim: 60000 $m^2$**

- Propozimi i tretë i pronave komunale për këmbim:
- **P – 70315016-00881-0,** me sip.99648 $m^2$, me kultur kullosë e kl.5 zona kadastrale Çikatovë e Vjetër,– pronë komunale, KK Gllogoc.

**Sipërfaqja për këmbim: 60000 $m^2$.**

Pronat private për këmbim:

- **P –70315016-00269-2,** me sip.71105 $m^2$, me kultur kullosë e kl.3, zona kadastrale Gllogoc, pronë private, pronar Newco Ferronikeli Complex L.L.C., sipërfaqja për këmbim 20000$m^2$.

- **P –70315016-01013-0,** me sip.206767 $m^2$, me kultur kullosë e kl.3 dhe rrugë, zona kadastrale Gllogoc, pronë private, pronar Newco Ferronikeli Complex L.L.C. Sipërfaqja për këmbim 40000 $m^2$.

**Sipërfaqja totale për këmbim 60000 $m^2$.**

**IV**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit i cili do të inicon procedurën e mëtejmë konform dispozitave ligjore në fuqi, për këmbimin e këtyre pronave në Zonat Kadastrale në Gllogoc dhe Çikatovë e Vjetër.

**V**

Vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe vlerësimi i pronës private, të cilat do të këmbehen do të bëhet nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme.

**VI**

Mënyra dhe kushtet e këmbimit të këtyre pronave të paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të pronës private që do të këmbehet.

**VII**

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodezike, kadastrale që nevojiten për këmbimin e këtyre pronave.

**VIII**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:

- Çertifikatat e pronësisë
- Skicat

**IX**

Ky Propozim – Vendim hynë në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Komunës së Drenasit dhe 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MPL-së në Prishtinë, dhe publikimit në ueb-faqen e Komunës.

**KRYETARI I KOMUNËS**
**Ramiz Lladrovci**

**A r s y e t i m**

Propozimi për këmbimin e këtyre parcelave është bërë me qëllim, të rregullimit të ngrohtores së qytetit të Drenasit.

Këmbimet e këtyre parcelave janë të domosdoshme si për pronarin e kësaj prone ku me këtë këmbim do të bëhet rregullimi dhe shfrytëzimi më i mire i pronës, po ashtu edhe për Komunën do të ishte i dobishëm ky këmbim, për ndërtimin e ngrohtore s së qytetit të Drenasit.

Parcelat të cilat kërkohet që të merren me këmbim janë të planifikuara si zona me interes të veçant Planin Zhvillimor Komunal 2020-2028 dhe Hartat Zonale 2022-2030.

Ekipi profesional i Drejtorisë për Gjedoezi, Kadastër dhe Pronë ka dal në vendshiqim dhe ka bërë inçizimin e pjesës së ngastrave kadastrale të shënuara më lartë të cilat do të këmbehen, e për të cilat pjesë janë nxjerrë edhe kopjet e planit dhe çertifikatat mbi të drejtat e pronës.

Të bashkangjitur e keni edhe skicën e terenit dhe çertifikatat e njësive kadastrale.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***
***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure***
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315016-01013-0

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **10/03/2023** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 10.03.2023 - 14:57 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Gllogoc / Glogovac / Gllogoc |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type | Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type | Zona U/R G/S U/R | Sipërfaqja Površina Area ($m^2$) | Përshkrim Opis Description | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-70315016-01013-0** | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | **206767** | 0019-86 | 24.12.2019 | 30.12.2019 |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur Mesto zvano Called place | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Emri i rrugës Naziv ulice Street name | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|
| SUKA | | | 24.12.2019 | 30.12.2019 |

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC - MUNICIPALITY GLLOGOC

**Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person**

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure | Rrugë/Put/Road | | 2716 |
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 3/Pasnjak 3 Klase/3rd Class Pasture | 204051 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qirambajtje 99 vite / Pod Zakupninom 99 godine / Leasehold 99 years | Newco Ferronikeli Complex L.L.C. | 810507444 | GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC / | | Ferronikeli | 1/1 | | 05.08.2020 |

## C. HIPOTEKA - HIPOTEKA - MORTGAGE

### C.1. Informata për hipotekën - Informacija o hipoteci - Mortgage information

| Shuma e borxhit<br>Iznos duga<br>Amount of debt | Shuma e borxhit me shkrim<br>Iznos duga slovima<br>Amount debt in writing | Data e kthimit<br>Datum isteka<br>Due date | Prioriteti<br>Prioritet<br>Priority | Afati dhe kushtet<br>Rokovi i uslovi<br>Terms and conditions | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 25000000 EUR | NjëzetPesëMilion | 27.07.2028 | 1 | Kredia me vlere prej 25.000000 euro me afat kthimi prej 8 vjet | Sipas kontrates mbi hipotek me nr lrp redn 3544/2020, ref.1018/2020 me dt. 17.07.2020 | 05.08.2020 |

### C.2 Komponentët e hipotekës - Komponente hipoteke - Mortgage components

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivalište<br>Residence | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| PENGDHËNËSI / Duznik-Hipotekarni / MORTGAGOR | Newco Ferronikeli Complex L.L.C. | 810507444 | GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC / | | Ferronikeli | Sipas kontrates mbi hipotek me nr lrp redn 3544/2020, ref.1018/2020 me dt. 17.07.2020 | 05.08.2020 |
| PENGMARRËSI / Poverilac-Hipotekarni / MORTGAGEE | BERZH -LONDER | 1778245 | PRISHTINË / PRIŠTINA / PRISHTINË / | | | Sipas kontrates mbi hipotek me nr lrp redn 3544/2020, ref.1018/2020 me dt. 17.07.2020 | 05.08.2020 |
| BORXHLIU / Duznik / DEBTOR | Newco Ferronikeli Complex L.L.C. | 810507444 | GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC / | | Ferronikeli | Sipas kontrates mbi hipotek me nr lrp redn 3544/2020, ref.1018/2020 me dt. 17.07.2020 | 05.08.2020 |

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA GLLOGOC - OPSTINA GLOGOVAC - GLLOGOC MUNICIPALITY

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315016-00269-2

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **10/03/2023** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 10.03.2023 - 14:57 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Gllogoc / Glogovac / Gllogoc |
